



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 19

Datë: 27. 05. 2019. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani, u.d. (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-se Nr. 16, 17 dhe 18/2019;
2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq;
3. Raport i Këshillave të KQZ-së:
 - a. Këshilli për Çështje Ligjore;
-Shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Fushë Kosovë;
-Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës
-Shqyrtimi i kërkesës së subjektit politik LDK
4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Ju përshëndes, e keni agjendën. A ka vërejtje ?

Anëtarët e KQZ, miratuan rendin e ditës pa ndërhyrje.

E kemi miratimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KQZ-se nr. 16, 17 dhe 18/2019. A ka vërejtje ?

Stevan Veselinoviq: Po, kam vërejtje lidhur me procesverbalin nr. 17. Kam thënë se, pika nr. 4 nuk është shqyrtuar përpara në këshillin për personel, kurse në procesverbal është për

“çështje juridike”, dhe po ashtu në procesverbal nuk është theksuar fjala ime që “të anulohet konkursi”, dhe nuk është që “ka pasur votim për zgjedhjen e panelit”.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalet me këtë përmirësim – vërejtje të z. Veselinoviq.

2.Certifikimi i rezultateve përfundimtare, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq:

1. **Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën e dytë: “Certifikimi i rezultateve përfundimtare, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq”. E kemi shkresën e PZAP-së, sipas së cilës nuk ka pasur ankesa, dhe sipas kësaj nuk ka ankesa as në Gjykatën Supreme dhe ne, nuk kemi pasur pse të dërgojmë shkresë në këtë gjykatë.

Florian Dushi: Unë kam diçka lidhur me këtë shkresë, të cilën PZAP e ka emërtuar si “Konfirmim për certifikim” dhe, ngjashëm me këtë emërtim, praktikisht është edhe përmbajtja e shkresës. Unë nuk e di kërkesën që ka shkuar nga ne, përmbajtja e saj, mirëpo është jo korrekte që PZAP në këtë njoftim thotë, “e keni paragrafin bazuar në nenin, në këtë e atë...”! Kjo, duket sikur PZAP na jep ne leje me i certifikuar rezultatet e zgjedhjeve...

Komunikoni me PZAP-në dhe shpjegoni që nuk është organ që na jep leje, veçse njoftimi i tyre është krejtësisht teknik...

Valdete Daka: Po, kjo është kështu...! Saktësisht. Atëherë, vazhdojmë me këtë pikë. Kush është për certifikimin e këtyre rezultateve...?

Janë 7 vota për, dhe asnjë kundër. Abstenime: 2. Tani, mund të konstatojmë se rezultatet për këto komuna, janë certifikuar.

Adnan Rrustemi: Pse abstenuam...? Qëndrimi ynë është në linjë të vlerësimit tonë që, 3 nga 4 kandidatët nuk kanë pasur bazë ligjore, dhe ne e kemi dërguar çështjen në Gjykatën Themelore për shqyrtim të ligjshmërisë. Kjo është arsyeja...

Pas kësaj, anëtarët e KQZ-së ri përsëritën certifikimin për secilën komunë, veç e veç për shkak se ishin katër vendime...

Adnan Rrustemi: Të kuptohemi, ne abstenojmë për secilën vendim...

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore:

1. *Shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Fushë Kosovë*

Florian Dushi: Këshilli, ka shqyrtuar tri çështjet. E para, është zëvendësimi në i një anëtari të asamblesë komunale në komunën e Fushë Kosovës. Fjalë është për Qerim Garën, i cili tani është zgjedhur nënkryetar, dhe se sipas procedurës, ky duhet të

zëvendësohet nga z. Hysni Hasani që është pas z. Gara me numrin e votave. Dokumentacioni është në rregull, dhe ne rekomandojmë për këtë zëvendësim. Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim nga subjekti politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës.

Florian Dushi: Çështja tjetër, ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së kryetarit të Komunës së Kamenicës që ka ardhur në adresë të komisionit me një temë të veçantë, organizimi i një referendum. Këshilli, e ka shqyrtuar kërkesën e tij, dhe natyrshëm, meqë ligji për referendumin mungon. Në mungesë të ligjit, edhe pse KQZ është organ që konsiderohet që organizon edhe referendume.

Valdete Daka: A duhet të vendoset...? Nuk po më duket në rregull, por... Anëtarët e KQZ-së, nuk e miratuan kërkesën në fjalë.

2. Shqyrtimi i kërkesës së subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës

Florian Dushi: Çështje tjetër që kemi shqyrtuar, është kërkesa e LDK-së që ndërlidhet me afatet që ndërlidhet me proceset e brendshme të zgjedhjeve. Këshilli, ka shqyrtuar kërkesën e subjektit LDK, dhe ne i rekomandojmë KQZ –së që ta aprovojë kërkesën e LDK-së për shtyrjen e afatit sa i përket përfundimit të procesit të brendshëm zgjedhor.

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën e subjektit politik: LDK.

Adnan Rustemi: Një vërejtje teknike: Në paragrafin e fundit nuk është precizuar afati, por ka edhe disa gabime gjuhësore...Ndoshta, kërkesa duhet të dërgohet nga kryetarja...

Florian Dushi: Sigurisht, më tutje do të merret zyra ligjore dhe kërkesa, duhet të nënshkruhet nga kryetarja...

4.Të ndryshme

(P.s. Në vazhdim, mbledhja ka vazhduar me dyer të mbyllura)